

## Vendim nr. 33 datë 22.02.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, në datën 22.02.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (E) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ERION ÇEREKJA, përfaqësuar nga avokat Agron Lamaj.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 46, datë 30.06.2023 të Komisionit të Përkohshëm “Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”; nr. 1637 prot., datë 16.05.2023 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi Erion Çerekja” të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 2, 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 2 i Rregullores së Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (*ligji nr. 96/2016*); neni 4 i urdhrit nr. 119, datë 12.07.2021 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Nga materialet e dosjes ka rezultuar se kërkuesi Erion Çerekja ka paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë tri shoqëri ndërtimi (bashkërisht investitore), duke kërkuar detyrimin për t'i dorëzuar apartamentin, sipas kontratës së porosisë, dhe shpërblimin e dëmit për vonesën e dorëzimit të tij.

2. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për sigurimin e padisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilën, me vendimin nr. 5909 akti, datë 24.09.2018, është vendosur pranimi i pjesshëm i kërkesës për sigurimin e padisë për regjistrimin e kërkesëpadisë dhe rrëzimin e kërkesave lidhur me vendosjen e sekuestros konservative për dy pasuritë (zyrë dhe apartament) në regjistrat e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, si dhe për pezullimin e punimeve. Kërkesa është shqyrtuar nga gjyqtarja M.Sh.

3. Pas ankimit të kërkuetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtarja A.K.) me vendimin nr. 1050, datë 15.11.2018, ka vendosur mospranimin e ankimit, pasi ishte bërë ndaj një vendimi të ndërmjetëm, konkretisht për rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit, ndaj të cilit nuk lejohet ankim i veçantë, por mund të ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar.

4. Kërkuesi në datën 10.05.2019 ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtares M.Sh., që gjykonte edhe çështjen e themelit, pasi nuk kishte pranuar kërkesën për përjashtimin e ekspertës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtarja M.O.), me vendimin nr. 522 akti, datë 27.05.2019, ka vendosur mospranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi për përjashtimin e gjyqtares, si të pabazuar në ligj dhe në prova.

5. Në vijim, kërkuesi në datën 11.07.2019 i është drejtuar Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (*ILD*), me ankesë për gjyqtaren A.K., që kishte shqyrtuar ankimin ndaj vendimit për rrëzimin e kërkesës për sekuestron konservative dhe për gjyqtaren M.O., e cila kishte shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtares që gjykonte çështjen në themel.

6. *ILD*-ja, me vendimin nr. 1637 prot., datë 16.05.2023, ka vendosur arkivimin e ankesës nr. 1262 prot., datë 19.06.2020 të paraqitur nga kërkuesi ndaj veprimtarisë së magistratëve, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kohën e kryerjes së shkeljes disiplinore të pretenduar.

7. Ndaj vendimit të *ILD*-së kërkuesi ka paraqitur ankim në Komisionin e Përkohshëm “Për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të *ILD*-së për arkivimin e ankimit ose pushimin

e hetimeve ndaj një gjyqtari” (KPSHA) të krijuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ). KPSHA-ja, me vendimin nr. 3080/4 prot., datë 30.06.2023, ka vendosur refuzimin e ankimit si të pabazuar. Vendimi është përfundimtar dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

8. Kërkuesi në datën 04.11.2023, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit, e cila pas plotësimit të dokumenteve është regjistruar përfundimisht në datën 04.12.2023.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

9. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

9.1. *Gjykimin të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm*, pasi vetëm për regjistrimin e kërkesës pranë organit kompetent ILD-së ka kaluar afati prej 1 viti, ndërsa për dhënien e vendimit 4 vjet. Një vonesë e tillë është tej konceptit të afatit të arsyeshëm. Në nenin 119 të ligjit nr. 96/2016 janë të përcaktuara qartë afatet kohore për procedimet e filluara nga ILD-ja, duke synuar procedura që janë në përputhje me fushën e veprimit dhe qëllimin e hetimeve disiplinore kundër magistratëve. Në bazë të nenit të sipërcituar ILD-ja konfirmon ankesën brenda pesë ditëve nga marrja e saj dhe ia njofton ankuesit vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit, si dhe mbylljen e hetimit brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

9.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi vendimet e ILD-së dhe të KPSHA-së në përmbajtjen e tyre nuk kanë respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve të organit të pushtetit publik. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5909, datë 24.09.2018, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës për sigurimin e padisë, duke u njohur e drejta e ankimit kundër vendimit, e cila u refuzua me vendimin nr. 1050, datë 15.11.2018 po të asaj gjykate. ILD-ja në lidhje me këtë pretendim ka arsyetuar se lidhet me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit procedural civil. Ky arsyetim është jo logjik dhe i drejtë, si dhe në kundërshtim me nenet 202-212 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). ILD-ja ka shmangur mungesën e hetimit të saktë të ankesës lidhur me veprimet e magistrates. Edhe arsyetimi i KPSHA-së nuk i përgjigjet së vërtetës dhe nuk shpreh asnjë gjë për vendimin e kundërshtuar. Në vendim nuk është arsyetuar për pretendimet e parashtruara për vonesën në dhënien e vendimit ose interpretimin e gabuar të normës ligjore nga ILD-ja. Vendimi karakterizohet nga mungesa e

analizës së materies, paraqitja logjike e arsytimit dhe nga uniteti në përmbajtjen e tyre, veçori e procesit jo të rregullt ligjor.

9.3. Së drejtës së aksesit në një gjykatë më të lartë, të garantuar në nenin 43 të Kushtetutës. Një ndër shkaqet e paraqitjes së ankimit në ILD ishte mohimi i së drejtës së ankimit në gjykatën e apelit për vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për rrëzimin e kërkesës për vendosjen e sekuestros konservative për dy pasuritë zyrë dhe apartament. Në nenin 209 të KPC-së parashikohet se ndaj vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankim i veçantë. Gjykata e faktit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës duke u njohur e drejta e ankimit të veçantë. Në këto kushte, vendimi i ILD-së paraqet shtrembërim të normës dhe nëpërmjet kuptimit të gabuar të saj është cenuar e drejta kushtetuese për të paraqitur ankim në një gjykatë më të lartë. KLGJ-ja nuk ka dhënë asnjë arsytim për këtë pretendimin.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë legjitimitetin si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe

reale për të (*shih vendimet nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se procesi administrativ i vënë në lëvizje nga kërkuesi/ankuesi ka pasur në objektin e tij verifikimin e përgjegjësisë disiplinore të magjistratit. Si i tillë, është një proces me rëndësi publike dhe nuk lidhet individualisht me të drejtat personale të individit. Për këtë të fundit, legjislacioni ka garantuar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të ILD-së në një organ *quasi gjyqësor*, siç është komisioni i posaçëm i krijuar pranë KLGJ-së, si një mjet transparence dhe për të rritur përgjegjshmërinë e organeve që administrojnë sistemin e drejtësisë. Pozicioni i individit si ankues në këtë procedurë nuk e kthen çështjen e përgjegjësisë personale të magjistratit në interes personal të kërkuesit. Po ashtu, në analizë të fundit, duhet theksuar se kërkuesi ka paraqitur ankesë në ILD për shkak të një procesi gjyqësor për të drejtën e pronësisë, që do të thotë se të drejtat dhe interesat e tij janë objekt i atij gjykimi. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* në kërkesën drejtuar Gjykatës me objekt shfuqizimin e vendimit të ILD-së, që ka vendosur arkivimin e ankesës të paraqitur nga kërkuesi ndaj dy gjyqtareve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit të KPSHA-së, që ka vendosur refuzimin e ankimit si të pabazuar.

13. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se në kushtet kur kriteri paraprak i legjitimitimit *ratione personae* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

14. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.